



# **Sigurimi bujqësor i bazuar në indeks të motit**

## **Produkt koncept për specin**

Projekti për financimin e sektorit të bujqësisë në Evropë dhe Azi  
Qendrore

## Përmbledhje e përgjithshme

Sigurimet bujqësore paraqesin një formë të menaxhimit të rrezikut që shfrytëzohet si mbrojtje nga humbja potenciale duke u ofruar fermerëve mundësinë e mbrojtjes nga rreziqet. Sigurimi bujqësor ofron mbrojtje nga humbjet në kulturat bujqësore. Përveç kësaj, sigurimi bujqësor paraqet një mjet të rëndësishëm për të zbutur rreziqet dhe për të siguruar rrugë më të sigurt për investimet e bankës.

## Sigurimi bujqësor i propozuar për specin

Speci është një ndër perimet më të rëndësishme në Kosovë në kuptim të sipërfaqes së mbjellur. Në vitin 2015 më shumë se 3,000 hektarë janë mbjellur me spec. Numri total i fermerëve të subvencionuar në vitin 2015 ka qenë 1,138 me një sipërfaqe totale të subvencionuar prej 1,356 hektarëve. Kjo kulturë kultivohet më së shumti në rajonin e Dukagjinit, i cili gjendet në pjesën perëndimore të vendit.

Pasi që sigurimi bujqësor është në fazat fillestare në Kosovë, nuk ka ende ekspertizë të mjaftueshme në dispozicion. Duke marrë parasysh numrin e madh të fermave me përmasa të vogla, me një mesatare prej 1.19 ha, është propozuar modeli i sigurimit sipas indeksit të motit për spec si modeli më i përshtatshëm dhe praktik për të filluar me të. Sigurimi tradicional kërkon ekspertizë të thellë dhe njohuri për sigurimin, vlerësimin e rrezikut dhe vlerësimin e humbjeve. Përparësitë e modelit të indeksit në krahasim me sigurimin tradicional janë renditur më poshtë:

- Sigurimi indeks mundëson mbulimin për fermerë të vegjël dhe individual;
- Për personelin e kompanive të sigurimit nuk kërkohet specializim në bujqësi;
- Nuk kërkohet ndonjë ekspertizë për t'i shitur polisat;
- Nuk kërkohet të kryhet ndonjë vlerësim i humbjeve për humbjet e shkaktuara;
- Sigurimi indeks është transparent pasi që lejon policë mbajtësit që të kenë qasje të drejtpërdrejtë në informatat në të cilat do të llogariten pagesat;
- Nuk është prezent rreziku i përzgjedhjes së pafavorshme;
- Nuk ka rrezik moral; dhe
- Kosto të ulëta operative dhe të transaksionit.

## Rreziqet kryesore për specin

Periodha e mbjelljes së specave të kultivuar në fusha të hapura varet nga rajoni. Në rajonin e Dukagjinit, periodha e mbjelljes bëhet gjatë fundit të prillit deri në dekadën e parë të majit, derisa në rajonin e Kosovës, kjo periudhë fillon më vonë- prej datave 1 qershor deri me 10 qershor, duke përfshirë komunën e Podujevës, ku mbjellja kryhet edhe më vonë, prej datave 15 qershor deri më 25 qershor. Për qëllime të këtij modeli të sigurimit, përqendrimi është tek reshjet e tepërta të shiut (shirat e mwdha). Rreziku ka efekt të lartë negativ, pasi që në situata kur mbjellja bëhet mbi lagështi, kjo gjendje krijon mjedis të përshtatshëm për zhvillim të sëmundjeve. Sëmundjet më të rëndomta të bimës së specit janë djegia bakteriale, kalbëzimi, sëmundja e rrënjës dhe kërcellit, dhe hiri i specave. Për shkak që sasia e reshjeve të shiut dallon nga rajoni ku kultivohet speci, edhe rreziku i shirave (reshjeve) të mëdha ka rrezikshmëri shumë më të lartë në rajonin e Dukagjinit, pasi që sasia më e madhe e reshjeve bie në periudhën kohore nga mesi i muajit maj deri në dekadën e parë të qershorit. Për këtë arsye, ky produkt i sigurimit ofrohet vetëm për këtë rajon.

Fazat e zhvillimit të specave janë të ndikuara nga faktorët e mëposhtëm:

- Për specin kërkohet më shumë nxehtësi sesa për domatet. Në temperaturën nën 15°C, si dhe në atë mbi 36°C, ndalet zhvillimi;
- Rezultatet më të mira të kultivimit të specave mund të arrihen në tokat e thella, të kulluara dhe tokë të pasur me humus;
- Është shfrytëzues i madh i ujit, i cili kërkon rënien e shiut dhe ujitjen prej 30-40 mm ose (30-40 l/m<sup>2</sup>) të sasisë së ujit. Për shkak të fuqisë së dobët të rrënjës për absorbim, kërkon më shumë ujitje; dhe,
- Vendndodhja - orientimi gjeografik i sipërfaqes së mbjellur (i njëjti varietet/ hibrid lulëzon më herët nëse parcela është e orientuar nga jugu dhe lindja, krahasuar me parcelat e orientuara nga veriperëndimi). Sidoqoftë, nuk ka dallime të mëdha mes datave të lulëzimit ndërmjet rajoneve të ndryshme.

### Periudhat e mbulimit, kufijtë dhe limitet e pagesave


Kuptimi i periudhës kritike të specit është një nga parametrat më të rëndësishëm për qëllime të sigurimit. Periudha kritike e specave në rajonin e Dukagjinit është periudha prej **15 maj deri me 10 qershor (gjithsejt 27 ditë)**, periudha me reshje të mëdha të shiut.

#### 15 maj – 10 qershor – shirat e tepërta

Kjo është faza e rritjes, degëzimit, lulëzimit dhe formimit të frutave të specit. Rritja, degëzimi, lulëzimi dhe formimi i frutave rrit nevojën për ujë. Rezultatet e testeve tregojnë që specat nga gjysma e dytë e qershorit deri në fundin e periudhës së vjeljes konsumojnë çdo ditë nga 3.5-4 mm ujë dhe në fazën e nevojës më të madhe për ujë, konsumimi shkon përtej 6 mm. Sidoqoftë, ngjarjet me reshje të mëdha ndodhin një herë në 6-7 vjet dhe shkaktojnë humbje të rendimentit deri në 40-50%. Kalkulimi i dëmshpërblimeve si pasojë e reshjeve të tepërta të shiut për këtë periudhë të mbulimit është përshkruar më poshtë:

Nëse gjatë periudhës së sigurimit do të akumulohen reshjet e shiut që tejkalojnë ose janë të barabartë me 110mm, pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 20%. Për çdo 10mm përtej 110mm, pagesa e dëmshpërblimit do të jetë 20%. Pagesa e dëmshpërblimit nuk mund të tejkalojë shumën prej 100% për të gjithë periudhën e siguruar.

**Figura 1. Periudha kohore e mbulimit të rreziqeve të specit**



## Përcaktimi i çmimit të sigurimit

Përcaktimi i çmimit është i bazuar në llogaritjet aktuariale për secilën pikë (grid) dhe rezultatet janë në dispozicion në broshurën e çmimeve (primeve) për kulturën e specit.

## Të dhënat e nevojshme meteorologjike për sigurimin e bazuar në indeks

Për sigurimin e bazuar në indeks të motit, janë përdorur të dhënat satelitore të DTN (MeteoGroup i mëparshëm), në bazë të të cilave është bërë dizajni i produktit, vlerësimi i rrezikut dhe më vonë do të bëhet edhe vlerësimi i humbjeve. Këto komplete të dhënash të rrjetit (të griduara) ofrojnë të dhëna për motin për elementet (faktorët klimatik) për të cilët nuk ka në dispozicion të dhëna të vëzhguara. DTN ka ofruar të dhëna historike të motit për 104 pika brenda gjithë territorit të Kosovës, ku për secilën pikë (grid) ofron informacion me të dhëna moti për një sipërfaqe/ lokacion prej 10x10km.

## Shuma e siguruar/ Limitet e pagesave

Shuma e siguruar/ Limitet e pagesave të dëmshpërblimit janë përcaktuar në bazë të kostove operative për prodhimin e specit. Shuma e sigurimit ofrohet për dy mundësi zgjedhjeje (opsione) – koston maksimale të prodhimit dhe koston e zvogëluar të prodhimit. Këty dy shuma të sigurimit janë renditur më poshtë:

- Zgjedhja e parë                      EUR 900.00 për Ha;
- Zgjedhja e dytë                      EUR 800.00 për Ha;

## Kush mund të ofrojë sigurimin bujqësor?

Sigurimet bujqësore do të ofrohen nga kompanitë e licencuara të sigurimeve, ndërmjetësit, agjentët, bankat, institucionet mikrofinanciare (IMF), që veprojnë në Kosovë me kusht që të licencohen nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK). Siguruesit duhet t'ia dorëzojnë Divizionit për Menaxhim të Rrezikut (DMR) dokumentacionin e domosdoshëm për miratim dhe përfshirje në sistem, para se të fillohet me shitjen e polisave standarde të sigurimeve indeks.